



Pranuar / Dorezuar Primi/Prilidato Received/Delivery	22-03-2023	3	viti god. year.
Organ /Njësia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMISHAK	2881/2023		1/2



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.440/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga: Arditë Haxhnikaj-Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari, me Ilire Mehmeti Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, duke vepruar sipas ankesës më numër A.nr.440/2023 të datës 01.03.2023 të parashtruar nga ankuesi _____, në çështjen juridike “kërkesë nga marrëdhënia punës”, bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 si dhe neni 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 i Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 22.03.2023, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.440/2023 të datës 01.03.2023, të parashtruar nga ankuesi _____

A r s y e t i m

Ankuesi _____ më datë 01.03.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 2211/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, kundër mos përfshirje së ankuesit në listën për shtesa dhe kushte të tregut të punës bazuar në Qarkoren 211-2/2023 të datës 08.02.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës,

Ndërsa, me datë 13.03.2023 ankuesi ka parashtruar kërkesë me numër protokollit 2578/2023 për tërheqjen e ankesës së parashtruar më datë 01.03.2023.

Kolegji i Këshillit pas pranimit të kërkesës me numër protokollit 2578/2023, e në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 103 paragrafi 1 ku përcaktohet se: 1. Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë”, vendosi që të përfundoj procedurën administrative të iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.440/2023 të datës 01.03.2023.

Theksuar si me sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit është i paligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.440/2023

Ilire Mehmeti-Shaqiri


Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Industrisë Ndërmarrësi; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

